



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 59**

**Datë: 10.12.2020. Ora: 11:00**

**Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.**

**Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.**

**Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Artan Asllani, Rifat Krasniq.**

**SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.**

**ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.**

**Përkthyes: Argjina Misini**

**Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.**

---

**RENDI I DITËS**

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes Nr.49, 52 dhe 53/2020.

- 2. Aktivitetet e SKQZ-së**

- 3. Aktivitetet e ZRPPC-së**

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të ZRPPC për Regjistrimin e Partise Politike Nasa Inicijativa.

- 4. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

- 5.**

**-Këshillipër Çështje Ligjore**

**-Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për zyren e Presidentit të Republikës së Kosovës**

**Këshilli për Operacione Zgjedhore**

-Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të SKQZ-së për asgjësimin/shkatërrimin e materialit zgjedhor, sipas aktgjykimeve të plotëfuqishme,

- Shqyrtim dhe miratimi i vendimit për asgjësimi-shkatërrimi e materialit zgjedhor për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura më 06 tetor 2019.

## **6. Të ndryshme.**

---

### **1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes Nr.49, 52 dhe 53/2020.

**Valdete Daka:** E hapi këtë mbledhje, a kemi vërejtje në rend dite...?

Në vijim të mbledhjes, anëtarët e KQZ-së miratuan procesverbet nga mbledhjet nr.49, 52 dhe 53/2020.

### **2. Aktivitetet e SKQZ-së**

**Burim Ahmetaj:** Raportin e keni pasur që dje në email. Janë të përmbledhura disa nga aktivitetet post zgjedhore, dhe nëse ka pyetje s'ka problem...

### **3. Aktivitetet e ZRPPC-së**

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të ZRPPC për Regjistrimin e Partisë Politike "Nasa Inicijativa"

**Yll Buleshkaj:** Zyra, ua ka dërguar një rekomandim për regjistrimin e një partie politike e cila i ka plotësuar të gjitha kushtet e kërkuara me ligj, janë shpjegimet në shkresë, dhe ne ju rekomandojmë për regjistrim. Ka qenë edhe në diskutim publik...Është partia 46 në regjistër...!

**Sami Kurteshi:** Ju po thoni se janë plotësuar kushtet teknike, kushtet administrative a janë të plotësuara...?

**Yll Buleshkaj:** Po, janë të plotësuara...!

**Alim Rama:** A ka pasur vërejtje gjatë periudhës së konfirmimit ?

**Yll Buleshkaj:** Jo, vetëm një telefonatë rreth programit...! Por, kjo neve nuk na intereson...

**Valdete Daka:** Kush është për që të regjistrohet partia "Nasha Inicijativa" me akronimin "Nasha" e cila, do të jetë partia e 46-të në regjistrin e partive politike...?

Anëtarët e KQZ-së, aprovuan rekomandimin e ZRPP-së për regjistrimin e kësaj partie të re politike të komunitetit boshnjak.

#### **4. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

##### **1.Këshillipër Çështje Ligjore**

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës

**Arianit Elshani:** Këshilli, ka shqyrtuar rekomandimin e zyrës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për zëvendësimin e deputetit Shpejtim Bulliqi, andaj me shumicë votash ( 1 votë kundër) është votuar që ky të zëvendësohet.

**Sami Kurteshi:** Unë për shkaqe parimore, realisht për shkak të kuotës gjinore nuk e kam votuar në mbledhjen e këshillit, as tani nuk e votoj...Dhe ky, nuk është as vullneti i Vetëvendosjes sepse po t'ishte ashtu ne kishim bërë selektim, i kishim zëvendësuar por, ne mendojmë se ligji nuk është i interpretuar drejtë...Kishte me qenë keq, sepse unë e kam mbajtur këtë parim dhe, nuk kisha me votue...

**Valdete Daka:** Kush është për që deputeti Shpejtim Bulliqi, deputet i deritanishëm, të zëvendësohet me kandidatin e radhës, Taulant Kryeziu...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim me 7 vota për, dhe 2 vota kundër ( Sami Kurteshi dhe Alim Rama), miratuan këtë zëvendësim.

##### **2. Këshilli për Operacione Zgjedhore**

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të SKQZ-së për asgjësimin/shkatërrimin e materialit zgjedhor, sipas aktgjykimeve të plotëfuqishme:

**Alim Rama:** Këshilli në mbledhje e tij, ka shqyrtuar miratimin e rekomandimit për shkatërrimin e materialit zgjedhor në bazë të vendimeve të akt fuqishme...Desha të theksoj se i gjithë materiali, të gjitha listat, materialet e bashkangjitura...rekomandohen nga gjykata që këto materiale të shkatërrohen...

**Sami Kurteshi:** A është e mundur që ndonjë dokument nuk është i përfunduar dhe ne, po e shkatërrimë...?

**Valdete Daka:** Jo, ne kemi një vendim të gjykatës Supreme, dhe nëse ka diçka, ata janë fajtorë...!

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim të KOZ-it.

Shqyrtim dhe miratimi i vendimit për asgjësimi-shkatërrimi e materialit zgjedhor për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura më 06 tetor 2019.

**Alim Rama:** Këshilli, gjithashtu ka shqyrtuar edhe vendimin për asgjësimin-shkatërrimin e materialit zgjedhor për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura më 06 tetor 2019. Këtu, janë materialet të tjetër që në bazë të rekomandimit të Sekretariatit, nuk ka vota të kontestuara...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim të KOZ-it.

**Valdete Daka:** Më duket sa kanë mbetur pa u asgjësuar ato të Mitrovicës së veriut, katër komunat për kryetar komune...! Sepse, me sa di nuk ka pasur kërkesa as nga PAZAP dhe as nga Prokuroria që të mos asgjësohen...

**Burim Ahmetaj:** Materiali është duke u selektuar, dhe kështu që...! Besoj në mbledhjen e radhës ua sjellim rekomandimin për asgjësim...

**Valdete Daka:** Më 12 dhjetor të këtij viti, parashkruhen të gjitha lëndët që kanë qenë për zgjedhjet e vitit 2010. Të gjitha parashkruhen, dhe ne nuk kemi çka t'i ruajmë...! Pra, të gjitha duhet asgjësuar...Në ndërkohë, në janar na parashkruhen edhe ato të vitit 2011...Është në pyetje parashkrimi absolut, dhe kjo është fuqia e ligjit...

## 5. Të ndryshme.

**Alim Rama:** Në mbledhjen e kaluar, kemi kërkuar listën e stafit, sa personave ju ndërpritet kontrata me datën 11-të...! Pra, sa janë edhe deri më 25...? Duhet të na dërgohet lista, madje me informim...

**Valdete Daka:** Po, duhet ta dimë këtë numër...